

Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët

për vitin aktual akademik 2024/2025 i krahasuar me vitet paraprake
2023/2024, 2022/23, 2021/22, 2020/21 dhe 2019/20

Programi: **MASTER-Inxhinieri dhe Menaxhimi i Prodhimit**

1. Hyrja

Në kuadër të këtij fakulteti, **Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës** ofrohet programi i studimeve **Inxhinieri Industriale me Informatikë**, në ciklin e parë, pra në bachelor, programi i studimeve në **Informatikë të Aplikuar**, në ciklin e parë, pra në bachelor, si dhe programi i studimeve në **Inxhinieri dhe Menaxhimi i Prodhimit**, në ciklin e dytë, pra në Master.

Programi - MASTER-Inxhinieri dhe Menaxhimi i Prodhimit ne kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Informatikës gjatë vitit akademik 2024/25 ka ofruar mësim për studentet sipas plan-programit të Akredituar në vitin 2019 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA). Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës ka një staf të kualifikuar dhe ka ambiente modern, salla dhe laboratorë të punës të cilat u mundësojnë studentëve të fitojnë shkathtësi të duhura për profesionin, të cilin do ta ushtrojnë në të ardhmen.

Misioni i programit është të zhvillojë kuadro të specializuara të profesionistëve në fushën e Inxhinierisë, me fokus në atë zhvillimin dhe dizajnin e produkteve duke përdorur teknologjinë dhe aplikacionet më moderne të TI-së, të cilat i përshtaten lehtë kërkesave të tregut të punës. Ky mision është në harmoni me misionin e institucionit “...të përgatisim profesionistë të kualifikuar dhe qytetarë të edukuar e të përgjegjshëm për të zhvilluar një karrierë profesionale dhe për të udhëhequr një jetë produktive.”

Ne kemi qëllim që të krijojmë profesionist në fushën e **Inxhinieri dhe Menaxhimi i Prodhimit**, duke ndihmuar në strukturimin dhe organizimin e kompanive industriale për të përmirësuar zhvillimin e kompanisë si dhe gjenerimin e ideve që avancojnë praktikën e Inxhinieri dhe Menaxhimi i Prodhimit.


Raporti përmban të dhëna për vlerësimin e programit nga studentet dhe për vlerësimin e mësimdhënësve nga studentet në programin **Inxhinieria dhe Informatika** për vitin aktual 2024/25 i cili krahasohet me tri vitet paraprake 2023/24, 2022/23, 2021/22, 2020/21 dhe 2019/20.

2. Raporti i përmblendhur i vlerësimit të cilësisë (program, mësimdhënës)

Raporti i përmblendhur - për dy fushat (program dhe mësimdhënës) paraqet ne Tabelën nr. 1 - statistikat për vitin akademik 2023/24 (krahasuar me vitet paraprake), i ilustruar edhe ne Fig.1. Pyetjet për dy fushat kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3- Pajtohem pjesërisht; 4-Pajtohem; dhe 5- Pajtohem plotësisht).

Tabela.nr.1 - Vlerësimi i cilësisë sipas fushave

	Vitet Paraprake					Viti aktual
	2019/20	2020/21	2021/22	2022/23	2023/24	2024/25
Vlerësimi mësimdhënia/nxënia (programi)	3.99	3.8	///	4.03	4.01	4.1
Vlerësimi i stafit akademik	4.0	4.4	4.4	4.4	4.42	4.4



Nga raporti përmblendhur i paraqitur në tabelën nr.1 në kuadër të fushës së vlerësimit të programit, gjegjësisht të mësimdhënies dhe mësimnxënies shohim një vlerësim në ngritje të (nga 3.99, 3.8, 4.03 dhe 4.01 në 4.1) të cilësisë nëpër dy vitet akademike, ndërsa për vitin akademik 2021/2022 nuk kemi vlerësim të programit.

Duke i u referuar tabelës, vlerësimi i cilësisë për tri vitet akademike është nën notën 4 (2019/2020 me 3.99, 2020/2021 3.8, 2022/2023 4.03 dhe 2023/2024 me 4.01 ndërsa për 2024/2025 është 4.1) që konsiderohet si vlerësim shumë i mirë por mbetet sfida që kjo të rritet në vitet në vazhdim.

Ne kuadër të fushës të vlerësimit të stafit akademik është një vlerësim i shkëlqyeshëm e tejkalon notën 4.0 në 2019/2020 dhe e tejkalon notën 4.4 në vitin akademik 2020/2021, 2021/2022, 2023/2024 me 4.42 si edhe 2024/2025 me 4.4 që konsiderohet si vlerësim i shkëlqyeshëm është një vlerësim shumë i mirë dhe premtues për të ardhmen e këtij programi.

3. Raporti i vlerësimit të Programit

Vlerësimi i programit **Inxhinieri dhe Menaxhimi i Prodhimit** 2024/25 (i krahasuar me vitet paraprake) është realizuar pyetësori i cili përmban 21 komponentë, ky vlerësim realizohet një herë brenda një viti akademik dhe vlerësimi bëhet nga studentët e programit përkatës. Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht).

Tabela nr.2 – Vlerësimi i programit – *Inxhinieri dhe Menaxhimi i Prodhimit*

Nr.		Vitet paraprake të gjitha programet)					Viti aktual
		2019/20	2020/21	2021/22	2022/23	2023/24	2024/25
1.	Materialet e prezantuara gjatë ligjëratare ju ofrohen studentëve rregullisht,	3.99	3.71	///	4.00	4.00	4.11
2.	Literatura e sugjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit,	4.25	4.05	///	4.27	4.00	4.8
3.	Syllabuset e lëndëve ofrohen me kohë studentëve,	4.17	3.86	///	4.27	4.17	4.28
4.	Studentët janë të njoftuar me orarin e konsultimeve të mësimdhënësve,	3.99	3.95	///	4.20	4.06	4.17
5.	Orari i konsultimeve me mësimdhënësit respektohet,	3.89	3.76	///	3.80	4.00	4.31
6.	Që në fillim të vitit studentët janë të njoftuar me mënyrën e vlerësimit për lëndën përkatëse,	4.29	3.86	///	4.20	4.00	4.44
7.	Metodat e mësimdhënies ofrojnë mënyrën më të mirë të arritjes së rezultateve të mësimdhënies,	4.00	3.90	///	3.87	4.22	4.33
8.	Mësimi on-line (përmes Microsoft Teams) nuk dallon shumë nga ai në klasë / Sallat e mësimi janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuale për konkretizimin e mësimi	3.28	3.67	///	3.13	3.56	4.03
9.	Sistemi i Menaxhimit Universitar (SMU) është i lehtë për përdorim dhe i plotëson nevojat e studentëve / Raporti në mes të pjesës teorike dhe laboratorike(praktike) të lëndëve është	4.34	3.67	///	3.87	3.94	4.32

	adekuat						
10.	Sallat e mësimit janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuele për mësim cilësorë / Studentit është i lirë që vet të përcaktohet për lëndë zgjedhore	3.96	3.71	///	4.13	4.00	4.25
11.	Ekziston një lidhje e mirë e mësimit teorik dhe atij praktik / Orari i mësimit shpallet me kohë	3.74	3.62	///	3.93	4.06	4.17
12.	Studenti është i lirë që vet të përcaktohet për lëndët zgjedhore / Orari i shpallur i mësimit respektohet nga mësimdhënësit	4.34	3.62	///	4.40	4.06	4.27
13.	Orari i mësimit shpallet me kohë / Programi i studimit është aktual me zhvillimet në këtë disiplinë te studimit	4.22	3.95	///	4.27	4.11	4.22
14.	Orari i shpallur i mësimit respektohet nga mësimdhënësit / Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në univ. e vjetra	4.07	3.81	///	4.13	4.06	4.37
15.	Programi i studimit është në përputhje me nevojat e tregut të punës / Angazhimi i studentit në lëndë është e balancuar (nuk është e mbingarkuar) / Vlera e ECTS-së për lëndën është e llogaritur sipas ngarkesës së studentit	3.99	3.90	///	4.13	4.00	4.11
16.	Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në Universitete të tjera / Puna praktike jashtë institucionit aplikohet me rregull	3.91	3.95	///	4.07	3.83	4.21
17.	Angazhimi i studentit në lëndë është e balancuar (nuk është e mbingarkuar) / Komunikimi i udhëheqësve të programit me studentë është në shkallën e duhur	3.87	3.95	///	3.93	4.17	4.28
18.	Puna praktike jashtë institucionit organizohet mirë nga universiteti / Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët	3.62	3.67	///	3.80	3.89	4.3
19.	Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët / Mendimi im i përgjithshëm për këtë program te studimit është pozitivë	3.68	3.95	///	4.13	4.00	4.4
20.	Mendimi im i përgjithshëm për këtë program të studimit është pozitiv / Këtë program të studimit do t'ia sugjeroj edhe personave të tjerë	4.10	3.95	///	4.07	4.06	4.17
21.	Këtë program të studimit do t'ia sugjeroja edhe të tjerëve					4.00	4.32
	Mesatarja e vlerësimit te programit	3.99	3.82	///	4.03	4.01	4.4

4. Raporti i vlerësimit të mësimdhënësit

Raporti vlerësimi për mësimdhënës paraqet statistikën për vitin akademik 2024/25 (i krahasuar me tri vitet paraprake 2019/2020, 2021/2022, 2022/2023 dhe 2023/2024-si vlerësim i të gjitha programeve). Pyetjet kanë qenë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likerit (1 - Nuk e di; 2 - Nuk pajtohem fare; 3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht).

Vlerësimi i mësimdhënësit/lëndës nga studentet është realizuar përmes pyetësorit i cili përmban 23 komponentë për të cilat është gjetur nota mesatare.

Nga të dhënat e prezantuar për mësimdhënësit dhe lëndët të cilat janë pjesë të programit **Inxhinieri dhe Menaxhimi i Prodhimit -Master** janë vlerësuar me note mesatare të shkëlqyeshme (në të gjitha vitet - nota mbi 4) kjo tregon se studentet e kanë vlerësuar kënaqëshmërinë e programit me **88%** që është një arriturë jashtëzakonshme për këtë program. Duke analizuar detajet e raportit vijmë në përfundimin se të gjithë mësimdhënësit dhe lëndët të cilat kanë marrë një vlerësim me të lartë (mbi notën 4) në bazë të këtyre të dhënave rekomandojmë që menaxhmenti i programit së bashku me mësimdhënësit dhe komitetin e programit duhet të angazhohen për të rritur nivelin e përgjegjësisë profesionale nga mësimdhënësit në të gjitha lëndët pa marrë parasysh rezultatin e shkëlqyer që kemi deri tani, duke bërë përpjekje që këto vlerësime të rriten edhe me shumë në vitet në vazhdim.